



A.nr.172/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.172/2026, të datës 16.02.2026, të parashtruar nga ankuesi A.Ç, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në mbështetjeje të Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 20.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprobhet si bazuar** ankesa më numër A.nr.172/2026, e datës 16.02.2026, e parashtruar nga ankuesi A.Ç
- II. Anulohet** Vendimi Nr.Ref:09/2026, i datës 22.01.2026, i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, çështja ***kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje*** të organi i njëjtë.
- III. Obligohet** Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të rishqyrtoj çështjen e ankuesit duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra në kuptim të zbatimit të vendimit.

A r s y e t i m

Ankuesi A.Ç (*me tej referuar ankuesi*) me datë 16.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Ref:09/2026, të datës 22.01.2026, të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak të tërheqjes/kthimit nga misioni diplomatik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje vetëm Këshilli*) bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e

Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku provat materiale referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 847/2026, të datës 16.02.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.Ref:09/2026, të datës 22.01.2026, të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Plotësimin e ankesës 18.02.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.02.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 25.02.2026; Akt Emërimit me Nr. 923/2024 të datës 01.08.2024; Vendimin me Nr. ref.53/2025 të datës 25.02.2025 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për emërim të ankuesit në mision diplomatik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e është e bazuar, ndërsa çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, *sepse*:

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave materiale, rezulton:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr. 923/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën Zyrtar i Lartë për Emergjencë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- Me Vendimin Nr. Ref. 53/2025, të datës 25.02.2025, të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi është caktuar të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb/Kroaci, me mandat katër (4) vjeçar, duke filluar nga data 01.05.2025, ndërsa, më datë 22.01.2026, Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka marrë Vendim me Nr. Ref: 09/2026, për tërheqje /kthim nga misioni diplomatik dhe atë nga data 02.03.2026.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në KPMSHCK kundërshton Vendimin Nr.Ref:09/2026, të datës 22.01.2026, të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më pretendimin se akti i kontestuar është nxjerr në mënyrë të kundërligjshëm, pa u respektuar procedurat e parapara me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse, akti i kontestuar nuk përmban fare arsyet me çka janë shkelur parimet ligjore, duke bërë tërheqjen nga misioni diplomatik në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë, sepse, përveç tjerash nuk është specifikuar se cila është nevoja e ministrisë që unë të tërhiqem nga misioni diplomatik. Kërkon të aprovohet ankesa dhe të anulohet akti i kontestuar.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për trajtim dhe vendosje lidhur me ankesën, iu referuar nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 1. *Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm;2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni,*

duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. 3. Në rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë.

Referuar përcaktimit ligjor si më sipër, Kolegji thekson faktin së fushëveprimi i shërbimit të jashtëm diplomatik është i rregulluar më akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, e në kontekst të çështjes, Kolegji iu referua:

I. Ligjin Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

-Neni 22:.. Përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhë katër (4) vjeçare, ose ndryshe siç kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrit të Punëve të Jashtme.

-Neni 23 paragrafi 2: 1. Presidenti i Republikës së Kosovës urdhëron tërheqjen e një ambasadori apo shefi të misionit nga misioni diplomatik përpara mbarimit të afatit të caktuar, për arsye të mëposhtme: 1.1. për nevoja pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme; 1.2. në bazë të kërkesës së vetë përfaqësuesit diplomatik; 1.3. për arsye të vlerësimit negativ të punës së përfaqësuesit diplomatik; 1.4. për shkelje të dispozitave të këtij ligji ose të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi; 1.5. kur një gjë e tillë kërkohet nga shteti pranues. 2. Tërheqja e të gjithë përfaqësuesëve të tjerë diplomatikë, duke mos e përfshirë shefin e misionit, për të njëjtat arsye të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet me urdhrin e Ministrit të Punëve të Jashtme.

II. Rregulloren Nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm(e plotësuar dhe ndryshuar me Rregullore nr.04/2014)

-Neni 10: ...8.Kohëzgjatja në detyrë për zyrtarët e angazhuar në shërbim jashtë vendit mund të ndryshojë sipas nevojave të shërbimit ose për shkak të rrethanave detyruese personale siç janë sëmundja ose vuajtje. 9. Ministria ka autoritetin të ndryshojë standardet e kohëzgjatjes së shërbimit varësisht nga kushtet e vendit të misionit ose nevojat e shërbimit”.

Rrjedhimisht, në kuptim të kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji ka analizuar aktin e kontestuar në ndërlidhje edhe më provat tjera materiale, nga vlerësoj së nuk është kontestuese kompetenca e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që zyrtarët e akredituar në misione diplomatike t'i transferoj nga një njësi në njësi tjetër diplomatike apo t'i tërheq nga misioni para përfundimit të misionit, nëse një veprim i tillë është i nevojshëm dhe në interes të ministrisë, mirëpo, në kuptim të parimit të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike, transferimi dhe tërheqjen e parakohshme nga misioni diplomatik të zyrtarëve të shërbimit të jashtëm duhet të përcillet më procedurë të njoftimit paraprak, të jetë i bazuar në kohë efektive të tërheqjes dhe së vendimi i tërheqjes apo transferimit të jetë i arsyetuar qartë duke specifikuar mjaftueshëm arsytet që sjellim tërheqjen/transferimin e zyrtarit nga misioni diplomatik. E në këtë kontekst konstatimi, Kolegji ve theksin të fakti së vendimi Nr.Ref:09/2026, i datës 22.01.2026, i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përbëhet vetëm nga pjesa hyrëse dhe dispozitivit, dhe si i njëjti nuk përmban fare

arsyetim dhe këshillë juridike, rrjedhimisht, Kolegji vlerëson se përveç se në pikën 1 të dispozitivit është cituar së ankuesi tërhiqet nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Kroaci për nevoja të institucionit, vendimi nuk përmban asnjë sqarim arsyetues së cila ka qenë nevoja e institucionit në këtë rast, veprim ky në kundërshtim më nenin 48, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) ku përcaktohet se: “*Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave si dhe 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret*”, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji konstaton së mungesa e arsytimit të pamjaftueshëm për nxjerrjen e vendimit të kontestuar është e barabartë më mungesën e tij siç përcaktohet më nenin 48 paragrafi 2 të LPPA-së citojmë: “*Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*”.

Në vështrim të mbrojtjes efektive juridike, Kolegji thekson qëndrimin e konsoliduar të Këshillit së në çdo rast kur më aktin administrativ vendoset për të drejta dhe detyrimet e nëpunësit civil, akti duhet të përmbaj të gjitha elementet e detyrueshme të akti administrativ sipas nenit 47 të LPPA-së, në mënyrë që pala ta kuptoj qartë dhe drejtë vendimarrjen, kështu që, një akt administrativ i nxjerr më mungesë të elementeve të akteve të detyrueshme konsiderohet akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të LPPA-së, andaj, mbi këtë bazë konstatimi e duke u bazuar në nenin 18 , paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, Kolegji aprovoj ankesën si të bazuar, anuloi aktin e kontestuar dhe lëndën e kthej në rishqyrtim të organi që ka nxjerr aktin e anuluar, më detyrimin që Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në ri procedurë të rishqyrtoj çështjen kontestuese dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim më pikëpamjet juridike të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.172/2026

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.Ç
- Organit të punësimit: Ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPJD dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së